



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 224/ 11 prot.

Datë 18.02.2026

V E N D I M

Nr. 275/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.02.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.185/2026, datë 03.02.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë”, me Nr. Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt "Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Ankimues: Operatori ekonomik “G .A .C” Shpk me NIPT L61619031A dhe adresë: Rruga Pylla e Zeqirit, Nr Pas 211/158, ZK 1605, Sauk, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) me adresë: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9

Subjekt i interesuar: OE “G & M CONSTRUCTION 07” SHPK me NUIS M21313027A, dhe me adresë Tiranë, Rruga Irfan Tomini Pasuria Nr 7/562-N12 Zona Kadastrale 8260.

OE “HTM” SHPK me NUIS K97006004D, dhe me adresë Shkoder, , Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44.

OE “NDERTUESI 2000” SHPK me NUIS J96409033R, dhe me adresë Bushat, Shkodër.

OE “MANE/S” SHPK me NUIS J64103865K, dhe me adresë Vlorë Sarandë, SARANDE, Lagja 2, P 46.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.185/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë”, me Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt “Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull”, me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 750/3 prot., datë 28.01.2026, të dërguar përmes shërbimit postar, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 224/3 prot., datë 02.02.2026.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “G.A.C” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1027/1 prot., datë 13.02.2026, protokolluar me tonën nr. 224/8 prot., datë 16.02.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) njofton se, ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 185/2026, datë 03.02.2026, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.185/2026 datë 03.02.2026, autoriteti kontraktor në datën 11.02.2026, ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të KPP-së nr. 185/2026, datë 03.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, hyrje në OST sha, me nr. 1027 prot., datë 06.02.2026 dhe vendimit të KSHA-së nr. 750/2 prot., datë 28.01.2026, duke identifikuar si ofertues të suksesshëm

OE "G.A.C" SHPK me nipt L61619031A. Bashkëlidhur kësaj shkrese ju përcjellim kopje të njehsuar me vulën e institucionit të Formularit të Njoftimit të Fituesit, si dokument provues mbi zbatimin e vendimit,

- Formulari i Njoftimit të Fituesit me nr. 561/1 prot., datë 13.02.2026;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 1027/1 prot., datë 13.02.2026, protokolluar me tonën nr. 224/8 prot., datë 16.02.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) njofton se, ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 185/2026, datë 03.02.2026, si vijon: ".....Në zbatim të vendimit nr.185/2026 datë 03.02.2026, autoriteti kontraktor në datën 11.02.2026, ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të KPP-së nr. 185/2026, datë 03.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, hyrje në OST sha, me nr. 1027 prot., datë 06.02.2026 dhe vendimit të KSHA-së nr. 750/2 prot., datë 28.01.2026, duke identifikuar si ofertues të suksesshëm OE "G.A.C" SHPK me nipt L61619031A. Bashkëlidhur kësaj shkrese ju përcjellim kopje të njehsuar me vulën e institucionit të Formularit të Njoftimit të Fituesit, si dokument provues mbi zbatimin e vendimit,

- Formulari i Njoftimit të Fituesit me nr. 561/1 prot., datë 13.02.2026;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar operatorin ekonomik "G.A.C." SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.185/2026, datë 03.02.2026, duke e kualifikuar këtë subjekt, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me anë dërgimit të Formularit të Njoftimit të Fituesit me nr. 561/1 prot., datë 13.02.2026, si dokument provues mbi zbatimin e vendimit.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur – me mjete elektronike – Punë", me Nr. REF-71635-12-10-2025, me objekt "Punime riparuese në N/St. 220 kV Rrashbull", me fond limit 12,342,954 (dymbëdhjetë milion e treqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e

katër) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 05.01.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

